



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë më 11 tetor 2019
Nr. Ref.:RK 1445/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI24/19

Parashtrues

Valon Miftari

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev.
nr. 276/18, të 10 shtatorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Valon Miftari (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në fshatin Duzhnje, komuna e Gjakovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 276/18, të 10 shtatorit 2018 (në tekstin e mëtejme: Aktvendimi i kontestuar), i cili i është dorëzuar atij më 4 tetor 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 4 shkurt 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 8 shkurt 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 27 qershor 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kërkesës në pajtim me ligjin iu dërgua Gjykatës Supreme. Të njëjtën ditë, Gjykatës Themelore në Gjakovë iu kërkuar fletëkthesa si dëshmi e pranimit të aktvendimit të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës.
8. Më 15 korrik 2019, Gjykata Themelore në Gjakovë, e informoi Gjykatën se parashtruesit të kërkesës aktvendimi i kontestuar i është dorëzuar më 4 tetor 2018.
9. Më 25 shtator 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Me vendimin e Gjykatës Supreme, Ap-Kz. nr. 221/2011, të 6 dhjetorit 2011, parashtruesi i kërkesës ishte liruar nga aktakuza për kryerjen e veprës penale në bazë të nenit 405, paragrafi (2) të KPPK-së.
11. Më 1 qershor 2012, parashtruesi i kërkesës, pasi ishte liruar nga të gjitha aktakuzat me aktgjykim të plotfuqishëm, ushtroi padi për kontest pune në Gjykatën Themelore në Gjakovë, kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, respektivisht Policisë së Kosovës, nëpërmjet së cilës kërkoi anulimin e akteve të Policisë së Kosovës, me të cilat i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës.
12. Më 22 korrik 2016, Gjykata Themelore në Gjakovë, me Aktvendimin C. nr. 192/2012, pasi vlerësoi kriteret e lejueshmërisë së padisë, konkludoi se padia ishte e paafatshme.
13. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, të 22 korrikut 2016, për shkak të shkeljeve të pretenduara të ligjit material dhe procedural.
14. Më 14 prill 2018, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin AC. nr. 3200/2016, refuzoi si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, të 22 korrikut 2016.
15. Parashtruesi i kërkesës, në afat ligjor, parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të ligjit material.
16. Më 10 shtator 2018, Gjykata Supreme, me Aktvendimin Rev. nr. 276/2018, refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të ushtruar nga parashtruesi i kërkesës dhe i konfirmoi si të drejta aktvendimet e gjykatave të instancës më të ulët.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta i është shkelur e drejta kushtetuese për mbrojtje gjyqësore të të drejtave për faktin se *“... të njëjtit i është mohuar e drejta në qasje në drejtësi, për faktin se pas lirimit nga akuza me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, AP-KZ. nr. 221/2011 i datës 6 dhjetor 2011 është krijuar një gjendje e re faktike me të cilën kanë pushuar kushtet për të cilat ankuesit i ishte shqiptuar masa largim nga vendi i punës, dhe se pa fajin e tij dhe në pamundësi faktike dhe juridike nuk ka pasur mundësi të atakoj aktet me të cilat është larguar nga puna”*.
18. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se nga arsyet e mësipërme i janë shkelur: *“... të drejtat elementare njerëzore dhe atë e drejta e mbrojtur e paraparë me nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe nenin 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në kuadër të së cilës të dëmtuarve i është shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe në barabarësi të*

palëve në procedurë, dhe e drejta sipas nenit 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në mbrojtje Gjyqësore e të Drejtave”.

19. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon: “... të anulojë dhe shpallë kundër kushtetueses vendimet gjyqësore dhe atë: 1. Aktvendimin e Gjykatës Themelore, C. nr. 192/2012, të dt. 22.07.2016, në Gjakovë 2. Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 3200/2016 të datës 11.04.2018, dhe 3. Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 276/2018, të datës 11.04.2018”.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

22. Gjykata po ashtu i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

[...]

“2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.

23. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; i ka shterur mjetet juridike në dispozicion; e ka specifikuar aktin e autoritetit publik të cilin e konteston në Gjykatë dhe gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë kushtetuese të cilat ai pretendon se i janë shkelur me vendimin e kontestuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit, si dhe e ka dorëzuar kërkesën në kohë, në pajtim me nenin 49 të Ligjit.
24. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

25. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe nenin 6 të Konventës, sepse i është mohuar e drejta për qasje në drejtësi dhe e drejta për mbrojtje gjyqësore të të drejtave, si rezultat i shkeljes së të drejtave nga marrëdhënia e punës.
26. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Gjakovë, hedhjen poshtë si të paafatshme të padisë së parashtruesit, e arsyetoi si në vijim: *“... vendimi i dt.21.03.2007 dhe aktgjykimi me të cilin është liruar nga të gjitha akuzat paditësi, gjykata ka konstatuar se padia është parashtruar pas afatit ligjor të paraparë me Ligjin e punës, neni 78 dhe 79 i Ligjit nr. 03/L-212, vendimi është lëshuar me dt.25.05.2007, ndërsa padia është parashtruar në Gjykatë më dt.01.06.2012 që do të thotë pas plotë 5 vite, që do të thotë se ka kaluar afati ligjor për parashtrimin e padisë”.*
27. Më tej, Gjykata e Apelit, pasi vlerësoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës të ngritura në ankesë për çështjet e afatshmërisë së padisë, argumentoi se *“Vendimet e të paditurës sipas të cilëve paditësi ka mbetur jashtë marrëdhënies së punës kanë marrë formën e prerë qysh në vitin 2007. Ai me këtë padi të fundit, të ushtruar me datën 1.6.2012, ka goditur dhe ka kërkuar anulimin edhe të letërdistribuit të të paditurës DPKP- 01/555/2012, i datës 24.5.2012, të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës (Sh. M.), i cili as nuk ka karakter “vendimi”, por që është njoftim i zakonshëm me të cilin paditësit i bëhet e ditur, sërish, se çështja e tij është çështje e përfunduar, dhe se nuk ka mundësi ligjore të kthehet në punë te e paditura.*

Paditësi, duke goditur "letërdistribuime të të paditurës" - nuk mundet që artificialisht t'i krijoj vetit afate të reja ligjore për të kërkuar mbrojtje gjyqësore të të drejtave të tij nga marrëdhënia e punës, gjë që ndërlikohet me vendimet e të paditurës që datojnë nga viti 2007, të cilat tani më as nuk mund të vlerësohen për shkak se kanë kaluar të gjitha afatet e parapara ligjore për këtë, edhe me ligjet e vjetra edhe me ligjet e reja, prandaj, gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur padinë e paditësit e ka hedhë si të paafatshme, prandaj rezultojnë në tërësi si të pabazuara pretendimet ankimore të tij dhe aktvendimi i goditur vërtetohet".

28. Si përfundim, parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar kërkesë për revizion dhe Gjykata Supreme, pretendimeve të tij në lidhje me afatshmërinë i është përgjigjur me arsyetimin vijues: *"Në këtë çështje juridike është vërtetuar se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me vendimin e Drejtorit të personelit Ref. nr. KPS/DP/AP/4024/D të datës 23.5.2007 të cilin e ka pranuar paditësi me datë 25.5.2007 e i cili vendim është definitiv pranë organit të punësimit. Paditësi pas pranimit të këtij vendimi nuk inicion kurrfarë procedure pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës e as në gjykatën kompetente, ndërsa ka parashtruar padinë në gjykatën e shkallës së parë me datë 1.6.2012 pasi që merr aktgjykimin më të cilin lirohet nga përgjegjësia penale, respektivisht pas skadimit të afatit prej 5 vitesh dhe mbi këtë bazë gjykatat e instancës më të ulët kanë vlerësuar se padia është ushtruar pas skadimit të afatit ligjor të caktuar me dispozitat e lartcekura dhe gjykatat e instancës më të ulët kanë vepruar drejtë kur të njëjtën e hedhin si të paafatshme. [...]".*
29. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta hodhën poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës për arsye procedurale, pasi vlerësuan se nuk ishin përmbushur kriteret e lejueshmërisë për shqyrtim meritor, për shkak se padia ishte ushtruar jashtë afatit kohor të paraprë me ligjet në fuqi.
30. Gjykata në këtë rast vlerëson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, në fakt, kanë të bëjnë me mënyrën se si gjykatat e rregullta në rastin e tij interpretuan dispozitat përkatëse të ligjit procedural, andaj, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në të vërtetë, ngrenë çështje të ligjit (ligjshmërisë) të cilat bien në fushëveprimin e gjykatave të rregullta dhe jo të Gjykatës Kushtetuese.
31. Gjykata ripërsëritë se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit dhe të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të provave ose zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj.
32. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, GJEDNJ rasti

Perlala kundër Greqisë, paragrafi 25 dhe *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 34, dhe shih, gjithashtu rastet: KI70/11, parashtues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011; dhe KI56/17, parashtuese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, para. 41).

33. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (shih, *mutatis mutandis*, Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, rasti KI86/11, me parashtues *Milaim Berisha*, i 5 prillit 2012).
34. Në këtë vazhde, Gjykata vlerëson se parashtuesi i kërkesës, ka pasur mundësi të mjaftueshme që para gjykatave të rregullta t’i prezantojë të gjitha pretendimet për shkelje të të drejtave të tij. Për më tepër, Gjykata konsideron se argumentet e tij janë dëgjuar në mënyrë të rregullt dhe janë shqyrtuar në mënyrë të duhur nga gjykatat e rregullta. Gjykata konsideron se vendimet e gjykatave të rregullta janë të arsyetuara dhe se procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, nuk kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih rastin e GJEDNJ-së *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Aktgjykim i 30 qershorit 2009).
35. Nga si më sipër, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës thjesht nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e tij me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, paragrafi 21, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005; shih Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, në rastin: KI25/11, me parashtues *Shaban Gojnovci*, të 28 majit 2012, paragrafi 28; shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtuese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
36. Si përfundim, Gjykata konsideron se kërkesa, në baza kushtetuese është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë.
37. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, ajo duhet të deklarohet e papranueshme.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, më 25 shtator 2019, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi